



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 1074/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me apelin e Suzana Sejdijaj, anëtare për Kuvendin Komunal në Vushtrri, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Vushtrri, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 16.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Suzana Sejdijaj, anëtare për Kuvendin Komunal në Vushtrri, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Vushtrri, me shenjen ZL.Anr.1074/2017, të datës 16.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 16.11.2017 ka pranuar apelin ZL.Anr.1074/2017 të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 10.11.2017, nga Suzana Sejdijaj, anëtare për Kuvendin Komunal në Vushtrri, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Vushtrri në të cilin kërkon që të bëhet numërimi i kutive të votimit për vendvotimet 2713B-5; 2702X-5; 2709B-3; 2720B-2; 2704B-14; 2718B-1; 2721B-2; 2701B-13; 2710B-3; 2707V-3.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresave të lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se parashtruesi në apel me asnjë provë bindëse nuk i ka argumentuar me prova pretendimet e tij në apel. Prandaj, Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në mbështetje të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.1074/2017 më datën 16.11.2017.



Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*